



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Adresa: Bulevardi "Zogu I", Godina 57/Nr. 18 Tiranë,

Tel/Fax 04 2226814 ; 04 2226814

Nr. 400 Prot.

Tiranë, më 21.06.2016

**V E N D I M**  
**Nr. 72, datë 21.06.2016**

***“Mbi përfundimin e procedimit administrativ,  
filluar me urdhrin e verifikimit nr. 400/1 prot, datë 10.06.2016”***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me procedurën e verifikimit të kryer në institucionin e Këshillit të Qarkut Durrës, për rastin e nëpunëses \*\*\*\*\*,

***VËREJ SE,***

Me Urdhrin nr. 400/1 prot, datë 10.06.2016, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka nisur verifikimi i ligjshmërisë të aktit administrativ nr. 9, datë 19.01.2016, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Durrës “Për lirim nga shërbimi civil të nëpunëses \*\*\*\*\*”, me anë të të cilit, është vendosur lirim nga shërbimi civil i nëpunëses \*\*\*\*\* duke i ndërprerë marrëdhëniet financiare dhe duke i dhënë të drejtat si nëpunëse civile.

Në zbatim të urdhrit të mësipërm, nëpërmjet shkresës nr. 400/2, datë 10.06.2016, “Njoftim mbi fillimin e verifikimit”, është vënë në dijeni Këshilli i Qarkut Durrës për këtë proces, duke i kërkuar edhe dokumentacionin e nevojshëm për realizimin e tij.

Nga ana e institucionit të Këshillit të Qarkut Durrës, në përgjigjen e dhënë me shkresën nr.949/1, datë 16.06.2016, drejtuar Komisionerit, është sqaruar se, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, mbi bazën e padisë së ngritur prej nëpunëses \*\*\*\*\* , ka filluar shqyrtimin e një çështjeje gjyqësore në datën 05.05.2016, ç`ka vërtetohet edhe me vendimin e gjykatës për njoftimin e kërkesë-padisë dhe të akteve shoqëruese, të cilat janë dërguar së bashku me informacionin e kërkuar në këtë rast.

Në këto kushte, bazuar në parimin e sanksionuar në nenin 36, të ligjit nr. 8116 datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, që institucionet e tjera nuk mund të shqyrtojnë çështje që po trajtohen apo janë trajtuar nga sistemi gjyqësor, vlerësohet se në këtë rast, nuk është e nevojshme ndërhyrja e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

**Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe nenin 34 të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

**VENDOSA:**

1. Përfundimin e procedimit administrativ të filluar me Urdhrin e verifikimit nr. 400/1 prot, datë 10.06.2016, “Për verifikimin e ligjshmërisë të Vendimit nr. 9, datë 19.01.2016, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Durrës, “Për lirim nga shërbimi civil të nëpunëses \*\*\*\*\*”.
2. Të njoftohen për këtë vendim, Këshilli i Qarkut Durrës si dhe kërkuesja, \*\*\*\*\*.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**